REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 667/22
Datë/Datum. 29.11.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

# RAPORTI I EKSPERTITT SHQYRTUES

| *Emri dhe Mbiemri i Ekspertit Shqyrtues* | *Nënshkrimi* | *Data e autorizimit të Ekspertit* | *Data e pranimit të autorizimit nga Eksperti* | *Data e dorëzimit të raportit* | Nr. i lëndës: |
|---|---|---|---|---|---|
| *Daut Retkoceri* | | *21.11..2022* | *21.11.2022* | *29.11.2022* | 667/22 |

## BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 17.11.2022 Operatori Ekonomik: **"Shkelqimi invest shpk" - Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me numër **PSH. Nr. 667/22**, pjesëmarrës në ftesën për ofertë lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi dhe meremitimi i shkollave - Maqitevë; 7 Marsi dhe Komunë Lot 1 Renocimi i shf Sadri Duhla - Laxhja Sopaj; shf Besim Ndrecaj Maqitev dhe shf. Ismet Jashari-Kumanova Javor Lot 2 Renovimi-fasadimi i shf Kongresi i Manastirit Studenqan, Flamuri i Arberit Reshtan".** me numër të prokurimit: **624-22-9770-5-2-1**, iniciuar nga **AK/ – Komuna Suharekë,** kundër Njoftim mbi vendimin e AK-së të publikuara përmes platformës e-prokurimi.rks-gov.net me datën 26.11.2022.
Autoriteti kontraktues ka zbatuar PROCEDURË TË HAPUR, lloji i kontratës :PUNË, vlera e parashikuar e kontratës:61,123.65 **€**

Konform nenit 113,114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETËNDIMET ANKIMORE TË OE "**Shkelqimi invest shpk" - Prishtinë**

Dispozitat *e shkelura dhe pikat e ankesës.*

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 7 – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi

*Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet*

AK Komuna e Suharekë me datë 26.10.2022 dërgon Njoftim mbi vendimin e AK-së lidhur me procedurën "Ndërtimi dhe meremetimi i shkollave - Maqitevë; 7 Marsi dhe Komunë Lot 1 Renovimi i shf Sadri Duhla - Laxhja Sopaj; shf Besim Ndrecaj Maqitev dhe shf. Ismet Jashari-Kumanova Javor Lot 2 Renovimi-

fasadimi i shf Kongresi i Manastirit Studenqan, Flamuri i Arberit Reshtan".

Në njoftim na vjen edhe letra standarde për eliminim për loto 1 aty ku kemi ofertuar, arsyeja e eliminimit shkruhet se është që nuk i kemi dërguar kontrata dhe referencat siç janë kërkuar në dosje të tenderit.

Ishte e çuditshme kjo arsye e cekur kur dihet se edhe ligji e precizon se në rast se dërgohet lista e kontratave mund të kërkohet sqarim nga OE.

Kjo nuk është shkelje dhe as kusht administrativ që duhet të eliminohet automatikisht, AK është dashur të kërkojë sqarime të referenca sepse janë dokumente ekzistenca e të cilave evidentohet para hajes se ofertave.

Neni 72 RRUOPP jep udhëzime se kur mund të kërkohen sqarime shtesë, AK përveç që ka bere shkelje të këtij neni, ka bere edhe shkelje të nenit të LPP që përmend se OE duhet të shfrytëzoj mundësitë për ruajtjen e parimit të ekonomicitetit dhe fillimisht të shfrytëzohen mundësitë për shpërblim të OE me të lire, siç kemi qenë në lotot 1.

Përfundimisht po e cekim që përderisa Lista e kontratave është dorëzuar me ofertë AK është dashur të kërkojnë sqarime shtesë dhe mos të shpërblej ofertën tjetër me të shtrenjtë.

Kërkojmë nga bordi i OSHP aprovimin si të bazuar të ankesës tonë dhe kthim të lendes në rivlerësim.

## KRITËRET PËR VLERËSIM

| ***Kërkesat e përshtatshmërisë:*** | ***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** |
|---|---|
| Kerkesa1. Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L068 dhe Ligjin Nr. 05 L-092 , Neni 65. Kërkesa2- OE duhet ta siguroje AK se ka kryer obligimet tatimore ndaj Komunës. Dëshmia kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet të Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit për Dhënie të Kontratës dhe nuk duhet të jetë me i vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit deri në ditën e dhënies. | Tenderuesi i plotëson Kërkesat për të konkurruar sipas Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04 L-042, Neni 65, duke përdorur formën në Aneksin 2 të Dosjes Tenderit. Dëshmitë lidhur me kërkesat e provueshmërisë që kërkohen nga tenderuesi që propozohet që të shpërblehet me kontratë dhe dorëzohen të Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dëshmia 1.2. Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit Tuaj të themelimit se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është në vonesë për pagimin e tatimeve, ky vërtetim duhet të jetë jo më i vjetër se 90 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të tenderit, duhet të dorëzohet nga OE të cilit synohet dhënia e kontratës (kopje).<br>Dëshmia 1.3. Një dokument nga Gjykata Kompetente, që vërteton se operatori ekonomik ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit dhe se ndaj tij nuk ekziston ndonjë rrethanë e përcaktuar me Nenin 65 paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 4.1, 4.2 dhe 4.4 të LPP-së jo më i vjetër se 6 gjashtë muaj nga data e dorëzimit të tenderit, duhet të dorëzohet nga OE të cilit synohet dhënia e kontratës, të dorëzohet në Origjinal ose kopje e vërtetuar. Dëshmia 2. Vërtetimi nga Komuna. Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontratë të sjellë |

| | |
|---|---|
| | dokumentet e kërkuara në pikat, 1 (1.1-1.3) dhe 2 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, dhe të vazhdoj me shpërblim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është rendit në vendin e dytë e kështu me radhë. |
| ***Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale neni 7.1 & 7.2*** | |
| Përshtatshmëria profesionale: | ***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** |
| regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit (kopje) Kërkesa2-Çertifikata e Numrit Fiskal, nëse nuk është e përfshire në certifikaten e biznesit (kopje) Kërkesa3-Çertifikata për Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK (kopje) | Dëshmia1- Çertifikata e regjistrimit të biznesit, se bashku me dokumentin Informatë mbi Bizneset (kopje). Dëshmia2- Çertifikata e numrit Fiskal nëse nuk është e përfshire në certifikatën e biznesit (kopje). Dëshmia3-Çertifikata për Regjistrim në TVSH (kopje). |
| **Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare neni 8.1 & 8.2** | |
| Kapaciteti ekonomik dhe financiar: | Dëshmia e kërkuar dokumentare: |
| Kërkesa1-Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i Operatorit Ekonomik, në tre vitet e fundit fiskale, është jo më pak se Lot 1 - 42,000.00 euro Lot 2 - 80,000.00 euro | Dëshmia1-Dokument nga banka për qarkullimin e OE ose pasqyrat e auditura financiare, ose deklaratat vjetore tatimore të dorëzuara në ATK. |
| **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2** | |
| Kërkesa1- Operatori Ekonomik duhet të ofroje dëshmi se ka përfunduar projekte të ngjashme në tre vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë së paku prej Lot 1 - 30,000.00 Euro, Lot 2- 55,000.00 Euro ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit DHE dëshmi për përfundimin me suksese të këtyre projekteve. Kërkesa 2 -Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Stafi i kualifikuar në fushën përkatëse, së paku -një Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë ose bachelor i ndërtimtarisë ose master i ndërtimtarisë që ka tri vite përvojë punë pas diplomimit | Dëshmia1 –Të dorëzoni listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjashme të realizuara në tre vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, dhe dëshmitë e përfundimit Referencat ose procesverbalet e pranimit teknik apo raportet përfundimtare për pranimin e punëve të kryera. Dëshmia2 - Kontrata e punës ose parakontrata me inxhinierin, Diploma e NOTERIZUAR, dokument dëshmi mbi përvojën e punës dhe një CV |

## RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

| |
|---|
| Raporti i vlerësimit për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore:<br>Komisioni pasi beri vlerësimin e ofertave i rekomandon ZP-së që të shpalli fitues për Lot-1 Xhevat Kokollari B.I me çmim 18.908.00 euro dhe Lot-2 Ekoterm me çmim 21.452,83 euro |

## INFORMACIONET SHTËSË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPËRTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

JO

## VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

OE ankues "Shkelqimi invest shpk" – Prishtinë sipas nenit 4.1.26 të LPP-së është palë me interes sepse është pjesëmarrës në ftesën për ofertë .

## VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTËT E NGJASHME

JO

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

JO

## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "Shkelqimi invest shpk" - Prishtinë

**PRETENDIMI NR.1**

Lidhur me pretendimin e OE "Shkelqimi invest shpk" – Prishtinë se AK – Komuna Suharekë – me "B58-NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES" na vjen edhe letra standarde për eliminim për loto 1 aty ku kemi ofertuar, arsyeja e eliminimit shkruhet se është që nuk i kemi dërguar kontrata dhe referencat siç janë kërkuar në dosje të tenderit".

**PËRGJIGJEJE NË PRETËNDIM NR.1**

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga operatori ekonomik "Shkelqimi invest shpk" – Prishtinë duke u bazuar në dokumentacionin që kam pasur në shqyrtim në sistemin e prokurimit publik - e-prokurim për ketë aktiviteti të prokurimit AK-ja me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, kriter për vlerësim ka kërkuar tek **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2** te **Kërkesa 1**-*Operatori Ekonomik duhet të ofroje dëshmi se ka përfunduar projekte të ngjashme në tre vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë së paku prej Lot 1 - 30,000.00 Euro, Lot 2- 55,000.00 Euro ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit DHE dëshmi për përfundimin me suksese të këtyre projekteve,* ndërsa si dëshmi të kërkuar për **Dëshmia1** –*Të dorëzoni listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjashme të realizuara ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, dhe dëshmitë e përfundimit Referencat ose procesverbalet e pranimit teknik apo raportet përfundimtare për pranimin e punëve të kryera*

Eksperti shqyrtues sqaron se Operatori ekonomik "Shkelqimi invest shpk" – Prishtinë ankues me ofertën e tij ka dorëzuar listën e projekteve të realizuare gjatë tri viteve të fundit , mirëpo nuk ua ka bashkëngjitë dëshmitë e kërkuara siç janë kërkuar : Referencat ose procesverbalet e pranimit teknik apo raportet përfundimtare për pranimin e punëve të kryera për as njërën nga kontratat të specifikuar në listën e dorëzuar për projektet e ngjashme të realizuara gjatë tri viteve të fundit

Eksperti shqyrtues sqaron se në RREGULLOREN Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK-nenin 38 Sqarimi i Tenderëve, alinea 38.5 në të cilin thuhet "*Autoriteti kontraktues mund të ftojë Operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë çertifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe* ***aftësisë teknike dhe profesionale****, çertifkatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE. I cili është dhe pretendimi i OE ankues për ketë rast është i pa zbatueshëm sepse OE-ankues nuk ka dorëzuara as një Referencat ose procesverbalet e pranimit teknik apo raportet përfundimtare për pranimin e punëve të kryera për as njërën nga kontratat të specifikuar në listën e dorëzuar siç kërkohen me aline 38.4 të po këtij neni Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtesë në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët ekonomik* ***me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta*** çertifkatave *të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje.*

**Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar**

## MENDIMI I EKSPERTITT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertit Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa: "Shkelqimi invest shpk" – Prishtinë ankues të merret si e pa bazuar. Të behet anulimi i Vendimit Mbi Pezullimin e Aktivitetit të Prokurimit ndërsa NJOFTIM PER VENDIMIN E AUTORITETI KONTRAKTUES -B58 të mbetet në fuqi dhe AK-ja të vazhdoj me këtë aktivitet të prokurimit sipas procedurave të përcaktuara në LPP.

Raporti i Ekspertizës ti dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues – Komuna Suharekës

Panelit Shqyrtues – OSHP-së.

OE ankues – "Shkelqimi invest shpk" – Prishtinë